

NR 417/13 PROT.
Dt. 10.09.2018

KUJTIM ÇASHKU

Përgjigje pyetsorit të QKK-së

Anetaret e kmp-ve mund te jene personalitete te huaj te te kinemase?

JO. Në KMP sipas ligjit të kinematografisë duhet të jenë personalitete vendase. Përfshirja e personaliteteve nga bota, përveç shvlerësimit të mëtejshëm të përgjegjësive të anëtarëve të KMP-ve, do të sillte dhe përplasje ligjore me Kushtetutën, por edhe me Kodin Fiskal dhe me ligjin e buxhetit të RSH. Siguria ligjore dhe financiare e shpenzimit të fondit publik, por edhe qëllimi Kombëtar I Qendrës së Kinematografisë do të çënosheshin rëndë.

QKK nuk është organ ndërkombëtar dhe nuk mundet të luajë një rol të tillë. Problemi është krejt i kundërt; papërgjegjshmërisht, ndër vite është stimuluar inflacioni i shoqatave pa kriter aftësie, merite apo kategorizimi me qëllim të vetëm, KAPJEN e KMP-ve për sigurim fondesh. Disa ndryshime të ligjit në vitin 2006, patën pasoja të rënda në shvlerësimin e kategorizimeve të zanateve(Shoqatat) por edhe në cilësinë e KMP-ve.

Nga ana tjetër mundet që QKK të formojë një këshill monitorimi dhe asistence me personalitete vendas e të huaj(rezidentë ose jo-rezidentë në Shqipëri) me profil të lartë profesional, në lidhje me strategjitë por sidomos me implementimin e ligjit të kinematografisë, ligjit për të drejtat e autorit, ligjit të mediave. Për këtë Këshill do të mjaftonte vetëm një modifikim i rregullores së QKK dhe ndoshta i statutit, si dhe parashikimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit të konsulentëve të huaj jo-rezidentë në Shqipëri si zë në buxhetin e QKK.

A duhet bere vleresimi I projekteve me pike?

JO. Vlerësimi i projekteve nuk duhet të bëhet me pikë por me votë individuale të përgjegjësme dhe me transparencë e përgjegjësi të plotë ligjore e profesionale, duke argumentuar me shkrim çdo anëtar i KMP-së përse meriton të financohet me para publike ose jo një projekt kinematografik, si vlerësim minimal e moral i punës voluminoze të kolegëve autorë dhe producentë.

Argumentat që duhet ti prapashtrohen aplikantit konkrues duhet te perfshijne

Më shumë se argumenta këto duhet të jenë kritere të komponentëve të vleruesimit nga KMP:

1. Cilësinë e skenarit,
2. Zgjedhja e regjisorit, skenaristit dhe kompozitorit, eksperiencia
3. Mundësia e realizimit te filmit nga ana producentëve, eksperiencia
4. Garancitë e koproduktorëve të huaj, eksperiencia
5. Kinoprovat, vëndet e xhirimit, dekoret e filmit.

Cilesia e filmit te maparshem te regjisorit qe perbehet nga keto elemente:

- a. Të ardhura nga shfrytëzimi ne salla ne kinemate shqiptare. 20%
- b. Të ardhura nga shfrytëzimi në rrjetet televizive numerike dhe analoge, kablllore, tokësore, satelitore, internet.

- c. Pjesëmarrja në festivale filmi të Kategorisë A të mëparshëm, sipas kategorive dhe seksioneve të kategorizimit të festivaleve të fiapf.org .
- d. Cmimet që ka fituar filmi i mëparshëm nga 20 - 60% sipas kategorisë së festivalit

Cilesia e skenarit konkurues

Në këtë rast, për të aplikuar në media duhet të kesh projektin(jo vetëm skenarin) të miratuar nga QKK vendase, sipas shpërndarjes së të drejtave në bazë të kombësisë së filmit.

- a. Konfirmohet se skenari ka fituar zhvillim projekti në programin media 50%
- b. Konfirmohet se skenari është përzgjedhur në një workshop për zhvillim skenari 20%
- c. Konfirmohet se skenari ka fituar një cmim në vlerë monetare 20%
- d. Konfirmohet se skenari ka fituar një cmim honorifik 10%

Cilesia e projektit konkurues

- e. Niveli potencial artistik, ekonomik dhe financiar i projektit sipas vlerësimit të Komisionit Financiar të QKK 40%
- f. Konfirmohet se projekti ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në një forum ndërkombëtar 10%
- g. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me cmim në një forum ndërkombëtar 10%
- h. Konfirmohet se projekti është vlerësuar me cmim financiar në një forum ndërkombëtar 40%

Bashkeprodhimi që ka siguruar projekti deri në momentin e aplikimit.

Konventa Europiane e Koproduksioneve, në fuqi prej 10 vitesh edhe në Shqipëri, është gjithashtu një bazë e fortë ligjore për koproduksionet e cila duke prealuar mbi legjislacionin vendas lë mundësinë për korrigjimin e disa defekteve. Konventa është rihartuar në maj 2017, dhe Konventa e re nuk është firmosur, ratifikuar dhe hyrë në fuqi, ende nga Shqipëria. Duhet ratifikuar sa më parë. Deri në ratifikimin e Konventës së re, Konventa e 1996 e ratifikuar dhe e hyrë në fuqi në Shqipëri në maj 2010, është ende në fuqi.

- a. Konfirmohet se projekti ka siguruar financim nga fonde publike të huaja 60-80%
- b. Konfirmohet se projekti ka siguruar fonde të tjera të besueshme alternative. 20-40%

Projekti të gezoje avantazh pasi siguron sukses paraprak nga pefshirja e profesionisteve

- a. Regjisor, skenarist dhe kompozitor i konfirmuar 50-70 %
Drejtor fotografie 10%(Konventa e Bernës për IP dhe Konventa Europiane e Koproduksioneve të dyja në fuqi në RSH, nuk e përfshijnë Drejtorin e fotografise tek autorët por si Drejtuesin Teknik më të lartë në sheshin e xhirimit. Duhet korrigjuar ligji ynë në bazë të konventave të ratifikuara nga RSH, ndyshe është shkelje.)
- b. Aktore të nivelit të lartë 20-40% (në varësi të buxhetit të koproduksionit)